



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2266/6 prot.

Datë 09.09.2025

V E N D I M
Nr.1201/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.09.2025 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me numër. 2266/2025 prot., datë 22.08.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-56847-07-31-2025, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për objektin : Ndërtim Rrugët Blloku Paskuqan 1”, me fond limit: 1,692,185.20 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë njëzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

Operatori ekonomik “A&E Engineering” SHPK me NIPT K72113010E dhe adresë Rruga Mujo Ulqinaku, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz me adresë Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.08.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-56847-07-31-2025, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për objektin : Ndërtim Rrugët Blloku Paskuqan 1”, me fond limit: 1,692,185.20 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë njëzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 11.08.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 20.08.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. BOE EMAR 21& MCE	1,506,305.05 lekë	Kualifikuar
2. NET-GROUP	1,510,459.17 lekë	Kualifikuar
3. BN PROJECT	1,522,966.68 lekë	Kualifikuar
4. MIKI CONSULTING	1,495,330 lekë	Skualifikuar
5. A & E ENGINEERING	1,499,933.13 lekë	Skualifikuar
6. Bersant Ylli	pa ofertë ekonomike	Skualifikuar
7. ProStruct	846,092.60 lekë	Skualifikuar
8. BOE ANGERBA & LENI-ING	1,493,468.83 lekë	Skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 21.08.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në datën 22.08.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5722, si dhe nr.2266/2025 prot, datë 22.08.2025 i operatorit ekonomik A & E ENGINEERING SHPK, i cili lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “A&E Engineering” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 2266/1, datë 22.08.2025.

II.7. Në datën 03.09.2025, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave operatori ekonomik ankimues, A & E ENGINEERING SHPK, me shkresën e datës 03.09.2025 me objekt “Terheqje nga ankesa”, protokolluar me tonën me nr.2266/2 prot., datë 03.09.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë për tërheqje nga ankesa me nr aplikimi A/2025/5722 , duke u shprehur se:

“Shoqëria A & E ENGINEERING SHPK në datën 22.08.2025 ka paraqitur pranë KPP një ankesë në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me Nr. REF-56847-07-31-2025, me Autoritet Kontraktor Bashkinë Kamëz dhe objekt prokurimi: “Mbikqyrja e punimeve per objektin : Ndërtim Rrugët Blloku Paskuqan 1”, me fond limit: 1,692,185.20 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë njëzet) lekë pa TVSHPër sa më sipër kërkojmë tërheqje nga ankesa me nr.aplikimi A/2025/5722.”.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.7440/1prot., datë 02.09.2029, protokolluar me tonën me nr.2266/3 prot., datë 04.09.2025, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) Nr.7440 prot., datë 02.09.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit në përfundim të shqyrtimit të ankesës ka vendosur refuzimin e saj.

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues, A & E ENGINEERING SHPK, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-56847-07-31-2025, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve per objektin : Ndërtim Rrugët Blloku Paskuqan 1”, me fond limit: 1,692,185.20 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë njëzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

II.1.1 Në datën 03.09.2025, nëpërmjet sistemit elektornik të ankesave operatori ekonomik ankimues, A & E ENGINEERING SHPK, me shkresën e datës 03.09.2025 me objekt “*Terheqje nga ankesa*”, protokolluar me tonën me nr.2266/2 prot., datë 03.09.2025, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë për tërheqje nga ankesa me nr aplikimi A/2025/5722 , duke u shprehur se:

“Shoqëria A & E ENGINEERING SHPK në datën 22.08.2025 ka paraqitur pranë KPP një ankesë në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me Nr. REF-56847-07-31-2025, me Autoritet Kontraktor Bashkinë Kamëz dhe objekt prokurimi: “Mbikqyrja e punimeve per objektin : Ndërtim Rrugët Blloku Paskuqan 1”, me fond limit: 1,692,185.20 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë njëzet) lekë pa TVSH. Për sa më sipër kërkojmë tërheqje nga ankesa me nr.aplikimi A/2025/5722.”.

III.1.2. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.3. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me numër 2266/2025 prot., për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues, “A & E Engineering SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-56847-07-31-2025, me objekt: “Mbikqyrja e punimeve për objektin : Ndërtim Rrugët Blloku Paskuqan 1”, me fond limit: 1,692,185.20 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dymijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë pikë njëzet) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik, “A & E Engineering” SHPK.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Florent Zguro

